Projekti "IT -Implementation of the European Agenda for Adult Learning", që i është besuar Isfol-it nga Ministria e Punës dhe e Politikave Sociale e nga Ministria e Arsimit, e Universitetit dhe e Kërkimit shkencor, dhe i financuar me 75% nga Komisioni europian, me një shifër baras me 364.500 Euro (Vendimi n. 2012-3853/001-001) lind për t'iu përgjigjur kërkesës për ta rritur nivelin e vetëdijes e të sensibilizimit lidhur me temën e mësimit të përhershëm pranë operatorëve publikë e privatë, palëve sociale, ndërmarrjeve, operatorëve të sektorit të tretë. Projekti synon para së gjithash, të përhapë e të përforcojë në nivel italian pesë përparësitë e Axhendës europiane për Mësimin në moshë të rritur, siç janë shtjelluar nga Axhenda e ripërtërirë për Mësimin e përhershëm:

"(....)Mësimi i përhershëm përmbledh periudhën nga para shkollës deri pas pensionit. Mësimi i të rriturve është element esencial i ciklit të mësimit të përhershëm që mbulon të gjithë gamën e veprimtarive të mësimit formal, jo formal e informal, si i përgjithshëm ashtu edhe profesional, të ndërmarra nga të rriturit pasi kanë lënë ciklin fillestar të arsimit e të formimit. (...) Duke pasur parasysh rrethanat specifike që ekzistojnë në secilin Shtet anëtar e sipas përparësive kombëtare, ftohen Shtetet anëtare, eventualisht të ndihmuara nga Komisioni, të përqendrohen në fushat e treguar këtu që u përgjigjen më mirë kërkesave të tyre specifike:

1. Të punohet në mënyrë që mësimi i përhershëm e lëvizshmëria të bëhen realitet;
2. Të përmirësohen cilësia e efektshmëria e arsimit dhe e formimit;
3. Të promovohen drejtësia, kohezioni social e qytetaria aktive nëpërmjet mësimit nga ana e të rriturve;
4. Të inkurajohen krijimtaria e novacioni i të rriturve dhe fushat e tyre të mësimit;
5. Të përmirësohet baza e njohurive për mësimin e të rriturve dhe të monitorohet sektori";
(nga Rezoluta e Këshillit për një axhendë të ripërtërirë për mësimin e të rriturve - 2011/C 372/01)

Në mënyrë të përmbledhur, projekti italian i përhapjes e i sensibilizimit për objektivat e Axhendës europiane, në përgjigje të përparësive të lart përshkruara, ka realizuar, në nivel kombëtar:

- një fushatë komunikimi *online* për temat e Mësimit në moshë të rritur
- një bazë të dhënash me një repertor të përvojave të realizuara në lëmin e Mësimit në moshë të rritur;
- një veprimtari gjallërimi territorial, komunikimi e promovimi të rrjetave nëpërmjet realizimit të *focus group* e të tre konferencave kombëtare në temat e mëposhtme: 1) Promovimi e përhapja e TIC (Teknologjitë e Informimit e Komunikimit) në Mësimin në moshë të rritur; 2) Mësimi në moshë të rritur e mësimet jo formale e informale; 3) Mësimi në moshë të rritur për qytetarinë aktive dhe drejtësinë sociale;
- një Raport për Komisionin europian mbi përfundimin e veprimtarive, edhe në lidhje me programimin e ri 2014-2020.

Njohja e gjuhës italiane për të marrë Lejeqëndrimin CE për qëndruesit afatgjatë

Broshurë informuese për qytetarët e huaj

Projekti "IT – Implementation of the European Agenda for Adult Learning" e ky material informues janë financuar me 75% nga Komisioni Europian

Përmbajtja e këtij raporti nuk pasqyron mendimin zyrtar të Bashkimit Europian. Përgjegjësia për informacionet e për mendimet e shprehura aty është tërësisht e autorëve.

(The project "IT – Implementation of the European Agenda for Adult Learning" and this publication has been financed by the European Commission)

(The content of this report does not reflect the official opinion of the European Union. Responsibility for the information and views expressed therein lies entirely with the authors)

Treguesi i lëndës

Njohja e gjuhës italiane

1. Dokumentet e vlefshme për të treguar njohjen e gjuhës italiane (e për të mos e bërë Testin)
2. Vërtetimi i njohjes së gjuhës italiane lëshuar nga një CTP
3. Certifikata zyrtare e njohjes së gjuhës italiane lëshuar nga një ent i njohur

Testi

1. Kush nuk duhet ta bëjë Testin?
2. Kush duhet ta bëjë Testin?
3. Regjistrimi për Testin
4. Zhvillimi i Testit
5. Kalimi i Testit
6. Ribërja e Testit

Njohja e gjuhës italiane

Nga dhjetori 2010 për ta kërkuar Lejeqëndrimin CE për qëndruesit afatgjatë (ish Karta e qëndrimit) duhet të tregosh se e njeh gjuhën italiane (të paktën në nivel A2 të Kuadrit të Përbashkët Europian).

Mund ta bësh në disa mënyra, alternative midis tyre:
A. *Me dokumente që ke prej kohësh ose dokumente për të cilat mund të kërkosh lehtë kopje të vërtetuar me firmë (për shembull diplomën e shkollës tetëvjeçare ose të mesme të marrë në Itali ose regjistrimin në universitetin italian).*
B. *Me Vërtetimin e njohjes së gjuhës italiane të nivelit A2 ose më të lartë të lëshuar pas ndjekjes së kursit në një Qendër provinciale për arsimin e të rriturve (CTP).*
C. *Me Certifikatën zyrtare të njohjes së gjuhës italiane të nivelit A2 ose më të lartë të lëshuar pas provimit nga një nga katër Entet certifikues (ose nga një subjekt i lidhur me marrëveshje me to) të njohura nga Ministria e Punëve të Jashtme e nga Ministria e Arsimit, e Universitetit dhe e Kërkimit shkencor.*
D. *Me Testin "ministror" të gjuhës italiane të organizuar nga Prefektura (niveli europian A2) posaçërisht për ata që kërkojnë Lejeqëndrimin CE.*

Nëse bën kërkesë përditësimi ose dublikatë të Lejeqëndrimit CE për qëndrues afatgjatë nuk duhet të tregosh njohjen e gjuhës italiane.

1. Dokumentet e vlefshme për të treguar njohjen e gjuhës italiane (e për të mos e bërë Testin)

Nëse dëshiron të bësh kërkesë për Lejeqëndrim CE mund ta tregosh njohjen e gjuhës italiane nëse gjendesh në një nga situatat e mëposhtme:

A. ***Ke marrë diplomën e shkollës dytësore të nivelit të parë ose të dytë në një shkollë të sistemit arsimor italian, ose në një Qendër provinciale për arsimin e të rriturve (CTP):*** *në këtë rast duhet të marrësh një kopje të vërtetuar me firmë të diplomës nga sekretaria e shkollës e t'ia bashkëngjitësh dokumentacionit që duhet të paraqitësh së bashku me kërkesën për Lejeqëndrimin.*
B. ***Ndjek një kurs studimesh në një Universitet italian shtetëror ose jo shtetëror të njohur ligjërisht:*** *dokumentacionit që duhet të paraqitësh së bashku me kërkesën e Lejeqëndrimit, duhet t'i bashkëlidhësh një dokument që të konfirmojë regjistrimin në vitin akademik në vijim.*
C. ***Ndjek në Itali doktoraturën ose një master universitar:*** *duhet t'i bashkëlidhësh dokumentacionit që duhet të paraqitësh së bashku me kërkesën e Lejeqëndrimit një dokument që të konfirmojë regjistrimin në vitin akademik në vijim.*

Nëse gjendesh në një nga këto situata nuk duhet ta bësh Testin por **duhet të përgatitësh dokumentacionin** që provon situatën tënde. Me fjalë të tjera, nuk mjafton të kesh diplomë ose të ndjekësh universitetin, por duhet ta provosh me dokumente, që i duhen bashkëlidhur kërkesës për Lejeqëndrim CE.

2. Vërtetimi i njohjes së gjuhës italiane lëshuar nga një CTP

Qytetari i huaj që kërkon Lejeqëndrim CE mund ta tregojë njohjen e gjuhës italiane nëse ka ndjekur prej kohësh një kurs të gjuhës italiane pranë një Qendre provinciale për arsimin e të rriturve (CTP) e nëse ka marrë në fund të kursit **Vërtetimin** e njohjes së gjuhës italiane të nivelit A2 ose me të lartë.
Në çdo Krahinë italiane ka qendra të ndryshme CTP ku mund të ndiqen kurse të gjuhës italiane e të merret Vërtetimi. Në faqen e internetit "Rai EDU Italiano Il grande portale della lingua italiana" (Rai EDU Italisht. Portali i madh i gjuhës italiane), mund të gjeni listën e Qendrave provinciale për arsimin e të rriturve (CPIA) krahinë për krahinë: http://www.italiano.rai.it/categorie/centro-territoriale-permanente/517/1/default.aspx
Qytetarët e huaj që kanë ndjekur një kurs në CTP nuk duhet ta bëjnë Testin por **duhet të përgatisin dokumentacionin** që provon situatën e tyre. Me fjalë të tjera, nuk mjafton ta kesh ndjekur kursin, por duhet ta tregosh me Vërtetimin që i duhet bashkëngjitur kërkesës për Lejeqëndrim CE. Kurset e organizuara në CTP kanë **kosto të ndryshme**, përgjithësisht të ulët. Disa janë tërësisht falas. Qytetarët që mendojnë se do ta kërkojnë Lejeqëndrimin CE mund të organizohen në kohë e të ndjekin një nga kurset e ofruara nga CTP për të marrë Vërtetimin e për të treguar kështu njohjen e gjuhës italiane. Në këtë mënyrë nuk duhet ta bësh Testin ministror.

3. Certifikata zyrtare e njohjes së gjuhës italiane lëshuar nga një ent i njohur

Nëse dëshiron të bësh kërkesë për Lejeqëndrim CE mund ta tregosh njohjen tënde të gjuhës italiane në qoftë se e ke kaluar provimin dhe ke marrë një **Certifikatë** zyrtare për njohjen e gjuhës italiane të nivelit A2 ose më të lartë të lëshuar prej një nga katër Entet certifikuese të njohura nga Ministria e Punëve të Jashtme e nga Ministria e Arsimit, e Universitetit dhe e Kërkimit shkencor (ose nga një subjekt i lidhur me marrëveshje me to):

A. ***CILS*** - *Universiteti për të huajt në Siena*
B. ***CELI*** - *Universiteti për të huajt në Peruxha*
C. ***IT*** - *Universiteti Roma Tre*
D. ***PLIDA*** - *Shoqëria Dante Alighieri*

Certifikata lëshohet pas një provimi të strukturuar me mënyra homogjene e me kritere të pranuara nga organizma ndërkombëtare. Katër Entet certifikuese kombëtare të lartcituara organizojnë provimin në selitë e veta ose në seli të ndryshme në të gjithë Italinë. Çdo Certifikatë e marrë në çdo vend është e vlefshme për kërkesën e Lejeqëndrimit.

Shënim:

CERTIFIKATA është dokument zyrtar, i njohur në nivel europian dhe i dobishëm në shumë kontekste private e profesionale, e merret pas një provimi të ndërlikuar e me pagesë.

VËRTETIMI lëshohet pas një kursi në CTP dhe mjafton për ta bërë kërkesën për Lejeqëndrimin CE edhe pse nuk ka vlerë zyrtare për qëllime të tjera.

Në disa Qendra provinciale për arsimin e të rriturve (CTP) mund të bëhet provimi për marrjen e certifikatës. Duhet të informoheni pranë çdo Qendre.
Edhe disa shkolla të gjuhës private e disa Qendra Gjuhësore pranë disa Universiteteve në vend ofrojnë mundësinë e zhvillimit të provimit për marrjen e Certifikatës zyrtare të gjuhës italiane.

Nëse ke një Certifikatë nuk duhet ta bësh Testin por duhet të përgatitësh dokumentacionin që provon situatën tënde. Në këtë rast, duhet pra t'ia bashkëlidhni Certifikatën kërkesës për Lejeqëndrim CE.

Testi

Testi ministror është një nga mënyrat për ta treguar njohjen e gjuhës italiane.
Nëse dëshiron të kërkosh Lejeqëndrimin CE për qëndrues afatgjatë e nuk mund ta tregosh njohjen e gjuhës italiane në mënyrë tjetër **duhet ta bësh Testin e ta kalosh** (**paragrafi 3**) **për ta bërë kërkesën për Lejeqëndrim.**
Megjithatë, ka disa raste për të cilat nuk është e detyrueshme ta bësh Testin.

1. Kush nuk duhet ta bëjë Testin?

A. *Fëmijët më pak se 14 vjeç (meqë nuk mund e nuk duhet të bëjnë kërkesë të pavarur nga prindërit për të kërkuar Lejeqëndrimin CE).*
B. *Kush ka Certifikatë zyrtare për njohjen e gjuhës italiane në nivelin A2 ose më të lartë të lëshuar prej një nga entet certifikuese të njohura nga Ministria e Punëve të Jashtme e nga Ministria e Arsimit, e Universitetit dhe e Kërkimit shkencor (CILS Universiteti për të huajt në Siena; CELI Universiteti për të huajt në Peruxha; IT Universiteti Roma Tre; PLIDA Shoqëria Dante Alighieri).*
C. *Ata që kanë Vërtetimin e njohjes së gjuhës italiane të nivelit A2 ose më të lartë të lëshuar pas ndjekjes së kursit të gjuhës italiane në një Qendër provinciale për arsimin e të rriturve (CTP).*

D. *Ata që kanë marrë diplomën e shkollës dytësore të nivelit të parë ose të dytë në një shkollë të sistemit arsimor italian ose në një Qendër provinciale për arsimin e të rriturve (CTP).*
E. *Ata që ndjekin një kurs studimi në një Universitet italian shtetëror ose jo shtetëror ligjërisht të njohur, ose ata që ndjekin në Itali doktoratën ose masterin universitar.*
F. *Ata që kanë kufizime të rënda e të vërtetuara të aftësisë në mësimin e gjuhëve për arsye moshe, patologjie ose paaftësie (dokumentacionit që paraqitet me kërkesën për Lejeqëndrim i duhet bashkëlidhur certifikimi i lëshuar nga një strukturë shëndetësore publike).*
G. Ata që bëjnë vetëm kërkesë përditësimi ose dublikatë të Lejeqëndrimit CE për qëndrues afatgjatë (sepse nuk duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës italiane e si rrjedhim nuk duhet ta bëjnë Testin).

2. Kush duhet ta bëjë Testin?

Qytetarët e huaj që **duan të bëjnë kërkesë** për Lejeqëndrim CE për qëndrues afatgjatë duhet ta bëjnë Testin në qoftë se nuk kanë mënyrë tjetër për të treguar njohjen e gjuhës italiane (d.m.th. në thelb në qoftë se nuk futen në një nga kategoritë e cituara në paragrafin 1 ose në qoftë se nuk arrijnë të organizohen për të marrë një Vërtetim ose një Certifikatë, **njohja e gjuhës italiane**).

3. Regjistrimi për Testin

Nëse dëshiron Lejeqëndrimin CE për qëndrues afatgjatë, duke zgjedhur dokumentimin e njohjes së gjuhës italiane me kalimin e Testit ministror, duhet të hapësh faqen e internetit **http://testitaliano.interno.it** e të përpilosh kërkesën për të bërë Testin duke hyrë në zonën tënde të rezervuar (me e-mail e fjalëkalim).
Është e detyrueshme të shkruash tek kërkesa një adresë **poste elektronike** të vlefshme. Adresa e dhënë do të përdoret për të komunikuar informacionet për takimin.
Për ta bërë kërkesën online për Testin duhet të kesh me vete Lejeqëndrimin aktual, një dokument identiteti, nga të dhënat e të cilit duhet të shkruash numrin e të dhënat e rezidencës dhe një adresë eventuale banimi. Është i disponueshëm shërbimi i asistencës (*help-desk*) që mund ta kontaktosh duke mbushur formularin e posaçëm në faqen internet **http://testitaliano.interno.it.**
Përpilimi i formularit ndahet në seksione; për të vijuar me dërgimin e kërkesës është e nevojshme të jepen të gjitha informacionet e kërkuara nga fushat që mund të seleksionohen; programi sinjalizon fushat që nuk i respektojnë kriteret e kërkuara.
Në qoftë se çdo gjë është e rregullt, **brenda 60 ditëve** Prefektura do të të komunikojë Qendrën për arsimin e të rriturve (CTP) ku do të bësh Testin, së bashku me datën dhe orarin. Prefektura do të komunikojë me ty me e-mail e letër. Për këtë arsye ka rëndësi të shkruash një adresë e-mail të vlefshme e ta kontrollosh rregullisht (të paktën një herë në javë). Në të njëjtën mënyrë, është e rëndësishme që letra të mund të vijë saktësisht. Pra duhet të siguroheni që emri tek zilja e derës të përputhet me atë që keni shkruar në kërkesën online për Testin (mundësisht, shënoni "*presso*" në rast se banoni tek njerëz të tjerë).
Në rast parregullsish ose mungesë kushtesh, sistemi gjeneron automatikisht e do të të dërgojë një komunikim me kushtet që mungojnë për të mundësuar korrigjimin e informacioneve.

Më pas, duhet të ndjekësh të gjitha udhëzimet e e-mailit e të letrës dhe të paraqitesh në kohë ranë CTP së treguar për të bërë Testin, duke sjellë me vete letrën e prefekturës e një dokument identiteti të vlefshëm.
Kujtohu që të sjellësh me vete një stilolaps të zi se blu! Nuk është e mundur të sillni fëmijët e mitur me vete, sepse nuk është parashikuar ndonjë shërbim për mbajtjen e fëmijëve.

4. Zhvillimi i Testit

Testi duhet të verifikojë se qytetari i huaj kupton disa situata të thjeshta që kanë të bëjnë me jetën e përditshme, familjen, punën, qytetin ku jeton e raste të ngjashme.
Testi bëhet në sallën e përbashkët të CTP e zgjat 60 minuta. Çdo pjesëmarrës merr një pliko që shërben për të plotësuar pyetjet e 3 provave:

1. Dëgjimi e kuptimi i 2 bashkëbisedimeve të shkurtra prej rreth 2 minutash secili (parashikohen 2 dëgjime), e përgjigjja e 5 pyetjeve për çdo pjesë. Kohëzgjatja: Rreth 25 minuta.
2. Leximi e kuptimi i 2 teksteve të shkurtra të shkruara, e përgjigjja e 5 pyetjeve për çdo tekst. Kohëzgjatja: Rreth 25 minuta.
3. Ndërveprim i shkruar. Duke ndjekur udhëzimet, përgjigjja e një kartoline ose një e-maili, mbushja e një formulari ose përgatitja e një kërkese për pjesëmarrje/regjistrim. Kohëzgjatja: Rreth 10 minuta.

5. Kalimi i Testit

Për ta kaluar Testin duhet të arrish të paktën 80% të numrit të përgjithshëm të pikëve. Nëse përfundimi i Testit është pozitiv, kërkesa jote për Lejeqëndrim CE për qëndrues afatgjatë ecën përpara automatikisht. Në fakt, rezultati i Testit futet në sistem nën kujdesin e Prefekturës kompetente, e cila e vë në dispozicion me anë të shërbimit ueb të Kuesturës për verifikimet që synojnë lëshimin e Lejeqëndrimit CE për qëndrues afatgjatë.
Rezultati i Testit mund të konsultohet nga ana jote në faqen internet http://testitaliano.interno.it me të njëjtën e-mail e fjalëkalim të përdorura për regjistrimin.

Në qoftë se përfundimi i testit është negativ:

Mund ta përsërisësh provimin e të bësh një kërkesë tjetër me kompjuter.

Në qoftë se përfundimi i testit është pozitiv:

Mund t'i paraqesësh Kuesturës kërkesën për lëshimin e lejeqëndrimit CE për qëndrues afatgjatë.

Pasi kalohet Testi, nuk lëshohet asnjë vërtetim. Pra nuk ka asnjë dokument për t'ia bashkëlidhur më pas kërkesës për Lejeqëndrim CE. Testi është i vetmi rast ku nuk duhet të kesh një dokument "fizik" për të treguar njohjen e gjuhës italiane (si për shembull nëpërmjet Vërtetimit ose Certifikatës). Nëse Testi nuk kalohet (ose kur nuk paraqiten dokumente që vërtetojnë njohjen e gjuhës italiane) kërkesa nuk pranohet.

6. Ribërja e Testit

Në qoftë se Testi është negativ qytetari i huaj mund ta përsërisë provimin. Pra duhet të bëjë një kërkesë të re për ta bërë Testin në faqen internet http://testitaliano.interno.it me të njëjtat e-mail e fjalëkalim.
Në rast mospjesëmarrjeje në test, mund të bësh menjëherë një kërkesë të dytë për të marrë pjesë vetëm në rast se mungesa është e vërtetuar.
Në rast mungese të pajustifikuar, mund të kërkosh një rezervim të ri vetëm pas 90 ditësh nga data e Testit ku ke munguar.

Burime

Faqe interneti:

www.miur.it

www.integrazionemigranti.gov.it

http://www.libertaciviliimmigrazione.interno.it/

www.provincia.bologna.it

Referime ligjore

- Marrëveshja Kuadër 11 Nëntor 2010 (lidhur me testin e njohjes së gjuhës italiane sipas DM 4 qershor 2010) midis Ministrisë së Arsimit e Ministrisë së Brendshme.

- Marrëveshja Kuadër 7 Gusht 2012 (që ka të bëjë me DPR 179/2011) midis Ministrisë së Arsimit e Ministrisë së Brendshme: në veçanti nenet 4 e 6 të Marrëveshjes Kuadër të 7 Gushtit 2012 përcaktojnë kriteret e mënyrat për zhvillimin e seksionit të formimit qytetar e të informacionit që duhet mbajtur pranë Qendrave Provinciale për Arsimin e të Rriturve - CTP e flukset informative të lidhura me detyrimet që atje parashikohen.

- Shënim i Ministrisë së Arsimit datë 28 dhjetor 2010: Vademekum: "Udhëzime tekniko-operative për përcaktimin e përmbajtjes së provave që përbëjnë testin, kriteret e caktimit të sasisë së pikëve dhe kohëzgjatja e testit.

- Ministria e Arsimit: "Udhëzime për projektimin e rrugëtimeve për alfabetizimin e mësimin e gjuhës italiane".

- Teksti i vetëm i dispozitave për disiplinën e imigracionit e të normave për kushtet e të huajve, sipas dekretit legjislativ 25 korrik 1998, n. 286, e ndryshime të mëpasshme i përditësuar me dekretligjin datë 23 qershor 2011, n. 89.

- Ministria e Brendshme – Dekret ministror 4 qershor 2010: Mënyrat e zhvillimit të testit të njohjes së gjuhës italiane, parashikuar nga neni 9 i dekretit legjislativ 25 korrik 1998, n. 286, i paraqitur nga neni 1, paragrafi 22, shkronja "i" e ligjit n. 94/2009.

- Ministria e Brendshme - Qarkorja n. 7589 e datës 16 nëntor 2010: Dekret ministror datë 4 qershor 2010 që përmban mënyrat e zhvillimit të testit të njohjes së gjuhës italiane nga ana e kërkuesve të lejeqëndrimit CE për qëndrues afatgjatë. Këto procedura kanë hyrë në fuqi në datën 9 dhjetor 2010.

- Ministria e Brendshme: Qarkorja e datës 3.2.2014 në fuqi nga 11 shkurti 2014.